

MONITORIMI I SHPENZIMEVE TË MINISTRISË SË MBROJTJES PËR VITIN 2012

Në zbatim të kreut VI, pikës 256 të udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012, të Ministrisë së Financave, "Për Procedurat Standarde për Zbatimin e Buxhetit ", të Ministrisë së Mbrojtjes, gjatë 12-mujorit të vitit 2012 ka planifikuar të administrojë dhe menaxhojë fondet buxhetore, sipas shtatë programeve të miratuara për Sistemin e Mbrojtjes dhe konkretisht:

1. Planifikim, Menaxhim dhe Administrim.
2. Forcat e Luftimit
3. Arsimi Ushtarak
4. Mbështetja Shëndetësore
5. Mbështetja e Luftimit
6. Mbështetja Sociale për Ushtarakët
7. Bashkëpunimi Civilo - Ushtarak

Sipas ligjit nr.10487, datë 04.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes është 19 910 milion lekë.

Buxheti rishikuar gjithsej në vlerën 19 865 milion lekë, gjatë vitit 2012 janë shpenzuar gjithsej 19 820 milion lekë, e duke pasur një realizim në masën 100 %.



Për periudhën janar-dhjetor të vitit 2012, buxheti i miratuar është realizuar në masën 100 % sipas treguesve në tabelë.

Tab. 1, Fondet buxhetore sipas programeve buxhetore të miratuar për vitin 2012, 12-mujori (buxheti 2012 në mijë lekë).

Nr.	Emërtimi	VITI 2012				
		PBA	Buxh (Ligji)	Plani me ndryshimet	Fakti	% ndaj ligjit
1	Planif. menaxh. administrimi	1.153	1,153	1,186	1,186	100
2	Forcat e luftimit	7.918	7,883	7,857	7,828	100
3	Arsimi ushtarak	979	979	904	902	100
4	Mbështetja shëndetësore	697	697	780	780	100
5	Mbështetja e luftimit	3.987	3,972	3,951	3,939	100
6	Mbështetja soc. për ushtarak.	4.500	4,500	4,500	4,500	100
7	Bashkëp. Civilo-Ushtarak	726	726	687	685	100
TOTALI		19,960	19,910	19,865	19,820	100

Struktura e shpenzimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, për çdo program sipas PBA, buxhetit fillestar të 2012 dhe realizimit faktik të 12-mujorit të vitit 2012, jepet në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Nr.	Emërtimi	VITI 2012			
		PBA	Buxh (Ligji)	Plani me ndryshimet	Fakti
1	Planifikim menaxhim, administrimi	5.8	5.8	6.0	6.0
2	Forcat e luftimit	39.7	39.6	39.6	39.5
3	Arsimi ushtarak	4.9	4.9	4.5	4.6
4	Mbështetja shëndetësore	3.5	3.5	3.9	3.9
5	Mbështetja e luftimit	20.0	20.0	19.9	19.9
6	Mbështetja sociale për ushtarakët	22.5	22.6	22.7	22.7
7	Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak	3.6	3.6	3.5	3.5
	TOTALI	100.0	100.0	100.0	100.0



Shpenzimet faktike të kryera gjatë 12-mujorit të vitit 2012 janë 39.5 % shpenzimet për programin "Forcat e Luftimit", 22.7 % shpenzimet për programin "Mbështetje Sociale për Ushtarakët", 19.9 % shpenzimet për programin "Mbështetja e Luftimit", 6.0 % "Planifikimi, Menaxhim Administrimi", 4.6 % "Arsimimi Ushtarak", 3.5 % programi "Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak" dhe 3.9 % programi "Mbështetja Shëndetësore".

Gjatë 12-mujorit të vitit 2012 janë shpenzuar gjithsej 19 819 milion lekë, duke rezultuar me një mbetje ndaj buxhetit vjetor në shumën 45 milion lekë dhe duke pasur një realizim në masën 100 %. Sipas grupeve kryesore të shpenzimeve, përqindja e realizimit ndaj buxhetit vjetor është:

- Shpenzime personeli 100%.
- Shpenzime të tjera korrente 99%.
- Shpenzime për mbështetjen sociale të ushtarakëve (ISSH) 100%.
- Investime të huaja 0%.
- Investime me financim nga buxheti shtetit 100%.

Realizimi 12-mujor në total, sipas programeve buxhetore paraqitet si më poshtë:

- Planifikim Menaxhimi 100 %
- Forcat e Luftimit 100%
- Arsimimi Ushtarak 100 %
- Mbështetja Shëndetësore 100 %
- Mbështetja e Luftimit 100 %
- Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak 100%
- Mbështetja Sociale për Ushtarakët 100% (ISSH)

Totali i shpenzimeve sipas programeve.

- Shpenzimet korrente 99.8%
- Shpenzimet kapitale 99.6%
- **Gjithsej 99.8%**

MONITORIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE

Në mënyrë më analitike sipas gjashtë programeve buxhetore, realizimi i buxhetit dhe produkteve të parashikuara për periudhën 12-mujori i vitit 2012, paraqitet sa vijon;

1. Planifikim, Menaxhim Administrimi (Titulli i Programit 01110)

Shpenzimet faktike të 12- mujorit të vitit 2012 në këtë program që përfaqëson rreth 6.0% të totalit të shpenzimeve të ministrisë, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor sipas ligjit të buxhetit, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korente 100%
- Shpenzimet kapitale 0.0%
- **Gjithsej 100%**

Për vitin 2012, u parashikuan 5 produkte në këtë program, të cilat rezultojnë të plotësuara si më poshtë:

PLANIFIKIMI, MENAXHIMI, ADMINISTRIMI			VITI 2012		Mbetja (1-2)	% Realizimit	Statusi i projektit
Kodi i Prod	Emri i Produktit	Ins.Buxh	(1) Buxh. i Rishikuar	(2) Fakti			
1	Personel i aparatit të MM dhe SHP	DASH	504,8	504,8	1	100	Realizuar
2	Bashkëshorte ushtarakësh të transferuar në MM dhe SHP		23,0	23,0	-	100	Realizuar
3	Pjesëmarrje në misione ushtarake ndërkombëtare		406,0	406,0	1	100	Realizuar
4	Funksionar publik dhe nënpunës civil që kompensohen me shërbim transporti		1,8	1,8	-	100	Realizuar
5	Marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara		250,0	250,0	-	100	Realizuar
TOTALI (në milion lekë)			1.185.8	1.185.8	2	100	

Në programin "Planifikim, Menaxhim, Administrim, shpenzime personeli, shpenzime korrente, produktet janë realizuar 100%.

- Personeli i aparatit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, janë realizuar në masën 100% për vitin buxhetor 2012.
- Në artikullin 606 deri më 31.12.2012, realizimi në masën 100%.
- Pjesëmarrja në misione ushtarake ndërkombëtare, realizimi në masën 100%.
- Në artikullin 605 , Marrëveshje ndërkombëtare të nënshkruara në masën 100%.
- Funksionar publik dhe nënpunës civil që kompensohen me shërbim transporti, realizuar 100%.

Produktet janë në proces realizimi sipas nevojave dhe parashikimeve të bëra në raportimin e treguesve të buxhetit sipas periudhave.

2. Programi "Forcat e Luftimit" (Titulli i Programit 02120)

Shpenzimet faktike të 12-mujorit të vitit 2012 në këtë program që përfaqëson rreth 39.5 % të totalit të shpenzimeve të ministrisë, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor sipas ligjit të buxhetit, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korrente 99,6 %
- Shpenzimet kapitale 99,6 %
- **Gjithsej 99,6 %**

Për vitin 2012, në këtë program u parashikuan 12 produkte, të cilat rezultojnë të plotësuara si më poshtë:

FORCAT E LUFTIMIT			VITI 2012		Mbetja (1-2)	% Rea lizi mit	Statusi i projektit
Kodi i Prod.	Emri i Produktit	Ins.Buxh.	(3) Buxheti i Rishikuar	(4) Fakti			
1	Personel në Komandën e Forcës Tokësore (FT), total (1001 Tr, 1010Shk, 1030, 1050)	Komanda e Forcës Tokësore	1.604,8	1.597,4	7,4	100	Realizuar
2	Bashkëshorte ushtarakësh që përfitojnë pagesë papunësie, FT.	Komanda e FT	20,6	19,8	0,8	100	Realizuar
3	Personel në Komandën e Forcës Detare (FD)	Rep.Usht. nr.2001 Durrës, Komand. FD	573,7	500,2	0,6	100	Realizuar
4	Personel në Komandën e Forcës Ajrore	Rep.Usht. nr.3001	503,7	500,2	3,5	99	Realizuar
5	Bashkëshorte ushtarakësh që përfitojnë pagesë papunësie, Rep.Usht.2001	Rep.Usht. nr.2001,	6,6	6,5	0,8	99	Realizuar
6	Bashkëshorte ushtarakësh që përfitojnë pagesë papunësie Rep.Usht.3001	Rep.Usht. nr.3001	14,7	14,5	0,2	99	Realizuar
7	Pajisje fushore të blera BrRSH	Rep.Usht. nr.1001	66,5	55,5	11,0	83	Proces
8	Blerje helikopteri transport shumërolesh	Rep.Usht. nr.3001	2.805,0	2.805,0	-	100	Realizuar
9	Ndërtim trupprojë 1 katëshe, Zall-Herr, Tiranë	Komanda e FT 1001	1	9	5	95	Realizuar
10	Ndërtimi i linjës së tensionit të lartë	Komanda e FT 1001	5	4	6	89	Realizuar
11	Ndërtim godine Poshnje, Berat	Komanda e FT 1001	2	1	1	94	Realizuar
12	Struktura e FA. Forca e Luftimit		2.261,3	2.255,4	5,8	100	Realizuar
TOTALI (në milion lekë)			7.857,1	7.827,5	29,6	100	

Siç shihet nga tabela e mësipërme, shpenzime personeli, shpenzime korrente, produktet janë realizuar në 100%.

Në artikullin 231, investim në nivel programi, pajisje të blera BrRSH, Reparti Ushtarak nr.1001, realizimi 83%, është në proces kryerja e pagesës përkundrejt kontraktorit për vitin 2012, mallrat do të dorëzohen brenda këtij viti buxhetor.

Për Repartin Ushtarak nr.3001 projektet si më poshtë:

- Projekti blerje helikopteri transport shumërolesh është realizuar 100%, për vitin 2012 është kryer pagesa e detyrimeve kontraktuale.

Produktet e tjera janë në proces realizimi për vitin buxhetor 2012.

3. Programi "Arsimimi Ushtarak"(Titulli i Programit 09430)

Shpenzimet faktike të 12-mujorit të vitit 2012 në këtë program që përfaqëson rreth 4.6% të totalit të shpenzimeve faktike të ministrisë, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor sipas ligjit të buxhetit, rezultojnë si më poshtë:

- Shpenzimet korrente 99,8%
- Shpenzimet kapitale 99,9%
- **Gjithsej 99,8%**

Për vitin 2012, u parashikuan 8 produkte në këtë program të cilat rezultojnë të plotësuar si më poshtë:

ARSIMIMI USHTARAK			VITI 2012		Mbetja (1-2)	% Realizimit	Statusi Produktit
Kodi i Prod.	Emri i produktit	Ins.Buxh	Buxheti i Rishikua	Fakti			
1	Personel në KDS(5001, 5560, 5561, 5570.)	Rep.Usht.nr.5001 KDS, Tiranë	589,6	589,3	0,2	100	Realizuar
2	Studentë të përgatitur Universiteti Ushtarak Skënderbej (UUS)	Rep.Usht.nr.5560 UUS, Tiranë	3	2	-	100	Realizuar
3	Bashkëshorte ushtarakësh që përfitojnë pagesë papunësie	Rep.Usht.nr.5001 KDS, Tiranë	16,1	15,9	1	99	Në proces
4	Ndërtim kabine elektrike 20kv	Rep.Usht.nr.5001 KDS, Tiranë	3,6	3,5	0,5	99	Realizuar
5	Sistemimi infrastrukturor	Rep.Usht.nr.5001 KDS, Tiranë	92,3	92,3	-	100	Realizuar
6	Përshtatje ambientesh për drejtorin e shifrës	Rep.Usht.nr.5001 KDS, Tiranë	1	1	0	100	Realizuar
7	Pajisje për Drejtorinë e Shifrës	Rep.Usht.nr.5001 KDS, Tiranë	1,2	1,1	14	99	Realizuar
8	Struktura e FA.(Rep.Usht.nr.5001)	Rep.Usht.nr.5001 KDS, Tiranë	199,6	198,6	9	100	Në proces
TOTAL (në milion lekë)			903,7	902,2	1,4	100	

Edhe në programin Arsimimi Ushtarak, shpenzime personeli, shpenzime korente, produktet janë realizuar në 100 %.

-Në kuadër të kremtimeve të 100-vjetorit të pavarësisë është iniciuar projekti “Sistemime infrastrukturorë në KDS”, projekt i cili ka përfunduar. Theksojmë se detyrimet financiare për këtë projekt shtrihen dhe në vitin buxhetor 2013.

-Projekti ndërtim kabine elektrike 20 kv është në proces pagese, projekt i mbyllur dhe i marrë në dorëzim.

-Produktet janë realizuar sipas nevojave dhe parashikimeve të bëra në raportimin e treguesve të buxhetit sipas periudhës.

4. Programi "Mbështetje Shëndetësore"(Titulli i Programit 07340)

Shpenzimet faktike për vitin 2012 në këtë program që përfaqëson rreth 3.9 % të totalit të shpenzimeve faktike të ministrisë, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor sipas ligjit të buxhetit, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korrente 100%
- Shpenzimet kapitale 0.0%
- **Gjithsej 100%**

Në këtë program janë parashikuar 4 produkte për këtë vit. Ecuria e produkteve të ngelura jepet nga tabela e mëposhtme:

MBËSHTETJA SHËNDETËSORE		VITI 2012		Mbetja	% Realizimit	Statusi i projektit
Kodi i Prod.	Emri i produktit	Buxheti i Rishikuar	Fakti			
1	Pacientë të kuruar dhe të ekzaminuar	301,5	301,5	0,1	100	Realizuar
2	Bashkëshorte të ushtarakëve të transferuar.	2,3	2,2	0,7	97	Realizuar
3	Pajisje elektromjekësore (kredi e huaj)	-	-	-	-	
4	Struktura e FA SUQU	476,1	476,1	-	100	Realizuar
TOTALI (milion lekë)		780,0	779,9	0,8	100	

Janë raportuar të dhëna mbi sasi të planifikuara dhe të realizuara për secilin nga produktet e përfshira në programin "Mbështetja Shëndetësore", shpenzime personeli, shpenzime korrente. Produktet janë realizuar në masën 100%, të 12-mujorit të vitit buxhetor 2012.

Produktet janë realizuar sipas nevojave dhe parashikimeve të bëra në raportimin e treguesve të buxhetit sipas periudhës.

5. Programi "Mbështetja e Luftimit" (Titulli i Programit 02150)

Shpenzimet faktike për vitin 2012 në këtë program që përfaqëson rreth 18.7 % të totalit të shpenzimeve faktike të ministrisë, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor sipas ligjit të buxhetit, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korrente 99,7%
- Shpenzimet kapitale 100%
- **Gjithsej 99,7%**

Në këtë program të 12-mujorit të vitit 2012, u parashikuan 15 produkte, të dhënat mbi sasi të planifikuara dhe të realizuara për secilin nga produktet e përfshira janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

MBËSHTETJA E LUFTIMIT			viti 2012		Mbetja (1-2)	% Realizimit	Statusi i projektit
Kodi i Prod.	Emri i produktit	Ins.Buxh	(1)Buxheti i Rishikua	(2) Fakti			
1	Personel në Brigadën Logjistike(4300,4302,4304)	4.300	1.002,1	1.002,1	-	100	Realizuar
2	Personel në Regjimentin e Mbështetjes (rep.4400,6660-QKFA,6640-ASNI,ISPVMB)	4.400	742,6	740,1	2,4	100	Realizuar
3	Personel në Qendrën e Personelit	6.670	67,7	66,3	1,4	98	Realizuar
4	Personel në Policinë Ushtarake	6.620	291,1	291,1	-	100	Realizuar
5	Ushtarakë të transferuar që përfitojnë pagesë papunësie (bashkëshorte)	rep. usht 4300, 4400, 6660, 6640, ISPVMB	32,1	30,0	2,1	93	Realizuar
6	Ushtarak në lirim që trajtohen me pagesë kalimtare	6.670	169.4	169.4	-	100	Realizuar

7	Personel në SHIU	6001	253.5	249.4	4.1	98	Realizuar
8	Personel në AKSHE	AKSH	23.5	23.5	0.4	100	Realizuar
9	Ushtarak që përfitojnë pagesë papunësie për bashkëshortet SHIU+AKSHE	SHIU+AKSHE	6.9	6.9	-	100	Realizuar
10	Personel QNOD	QNOD	22.3	22.3	0.6	100	Realizuar
11	Struktura e FA QNOD	QNOD	4.6	4.6	-	100	Realizuar
12	Rikonstruksion QKU, ESKU, Tiranë, Rep.6660	6.660	28.4	28.4	-	100	Realizuar
13	Pajisje hardware të teknologjisë multimedia	6.660	1.0	1.0	-	100	Realizuar
14	Rikonstuksion grupe depo, Brarë	4.300	5	5	-	100	Realizuar
15	Struktura e FA Mbështetja e luftimit	FL	1.304.1	1.302.7	1.3	100	Realizuar
	TOTAL (milion lekë)		3.950,5	3.938,9	11,6	100	

Për vitin 2012, u parashikuan 15 produkte në këtë program të dhënat mbi sasi të e planifikuara dhe të realizuara në masën 100 %. Produktet e përfshira janë paraqitur në tabelën e mësipërme.

Janë raportuar të dhëna mbi sasi të e planifikuara dhe të realizuara për secilin nga produktet e përfshira në programin Mbështetja luftimit.

- Për Repartin Ushtarak nr.6660, rikonstruksion QKU, ESKU kontratë në vazhdim.

Siç shihet nga tabela e mësipërme, shumica e produkteve nuk janë në procese realizimi.

6. Programi "Mbështetje sociale për ushtarakët"(Titulli i Programit 10270)

Shpenzimet faktike të 12-mujorit të vitit 2012 në këtë program që përfaqëson rreth 22.7 % të totalit të shpenzimeve faktike të ministrisë, sipas zërave kryesor, krahasuar me planin vjetor sipas ligjit të buxhetit, rezulton si më poshtë:

- Transferta korrente të brendshme 100 %
- **Gjithsej 100 %**

MBËSHTETJA SOCIALE PËR USHTARAKËT		VITI 2012		Mbetja (1-2)	% Realizimi	Statusi i projektit
Kodi i Prod.	Emri i produktit	(1) Buxheti i Rishikuar	(2) Fakti			
A	Ish-ushtarakë që trajtohen me pensione suplementare	4.500,0	4.500,0	-	100	Realizuar
	TOTALI (milion lekë)	4.500,0	4.500,0	-	100	

Në këtë program, shpenzime personeli, shpenzime korrente, produktet janë realizuar në masën 100 %.

7. Programi "Bashkëpunimi Civilo-Ushtarak" (Titulli i Programit 02280)

Shpenzimet faktike të 12-mujorit të vitit 2012 në këtë program që përfaqëson rreth 3.5% të totalit të shpenzimeve faktike të ministrisë, sipas zërave kryesorë, krahasuar me planin vjetor sipas ligjit të buxhetit, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet korrente 99.7%
- Shpenzimet kapitale 0.0%
- **Gjithsej 99.7%**

Në këtë program janë parashikuar 3 produkte për këtë vit, ecuria e produkteve jepet nga tabela si më poshtë :

BASHKËPUNIMI CIVILO-USHTARAK			VITI 2012		Mbetja (1-2)	% Reali zimit	Statusi i projektit
Kodi i Prod.	Emri i produktit	Ins.Buxh	(1) Buxheti i Rishikuar	(2) Fakti			
1	Personel i Brigadës Mbështetëse Rajonale (BrMR)	Rep.Usht. nr.1320	619,3	590,9	0,9	100	Realizuar
2	Ushtarakë të transferuar që përfitojnë pagesë papunësie (bashkëshorte)	1.320	13,9	12,9	0,9	93	Realizuar
3	Struktura e BrMR	1.320	81,5	81,5	0,1	100	Realizuar
TOTALI (milion lekë)			687,3	685,4	1,8	100	

Janë raportuar të dhëna mbi sasi të planifikuara dhe të realizuara për secilin nga produktet e përfshira në këtë program "Bashkëpunim Civilo-Ushtarak", shpenzime personeli, shpenzime korrente. Produktet janë realizuar në masën 100 %.

Realizimi i treguesve buxhetorë të periudhës raportuese paraqitet si më poshtë:

Në artikullin 600, "**Paga e shtesa mbi pagë**" realizimi **100%** kundrejt planit të periudhës. Janë likuiduar të gjitha detyrimet ndaj personelit.

Në artikullin 606 janë realizuar **93%** kundrejt planit të periudhës.

Në artikullin 602, "**Blerje, mallra e shërbime**", realizimi është në masën **100%** kundrejt planit të periudhës.